

Komisioneri Publik ankimon vendimin për gjyqtaren e Apelit, Elona Toro



Komisioneri Publik ankimoj vendimin e konfirmimit të gjyqtares së Apelit Tiranës, Elona Toro.

Në një njoftim në faqen zyrtare, KP i kërkon Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të riçeli dhe një herë hetimin për gjyqtaren në të trija kriteret, pasi nuk arrin një nivel të besueshëm për tu konfirmuar në detyrë.

“Komisioneri Publik kërkon nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit që të riçelë hetimin gjyqësor, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në gjendjen që janë aktet, nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin në detyrë.”

Elona Toro u konfirmua në detyrë nga KPK me 17 qershor.